

FINANCA NDËRKOMBËTARE

KOMUNIKIMI DHE TRANSFERTAT E FONDEVE

Vëllimi i madh i tregtisë në tregun e valutave kërkon rrjet komunikimi të gjërë midis tregtarëve dhe një sistem të sofistikuar të shlyerjes për të transferuar pagesat në valuta të ndryshme ndërmjet blerësve dhe shitësve në vende të ndryshme.

SISTEMET E KOMUNIKIMIT

Deri në vitet '70, komunikohesh përmes telefonit dhe teleksit. Sot, tregtarët i ndjekin ekranet kompjuterike, të dhënat e ofruara nga shpërndarësit kryesorë të informacionit komercial, siç janë *Reuters* dhe *Bloomberg*.

Psh: Supozojmë se *Citibank* dëshiron të marrë një shumë të madhe eurosh. Ka tri mënyra për ta bërë këtë:

- 1) Mund të kontaktojë tregtarët në bankat e tjera të mëdha, sikurse *BNP Paribas*.
- 2) Mund të kontaktojë një ndërmjetës të këmbimit valutor për të marrë listimit dhe të arrijë marëveshje.
- 3) Mund të tregtojë në sistem ndërmjetsimi elektronik ku transaksionet bëhen sipas listimeve të shfaqura në ekran.

SISTEMET E KOMUNIKIMIT

Kur dy tregtar arrijnë marrëveshje për një transaksion, bankat e tyre komunikojnë dhe i transferojnë fondet në mënyrë elektronike nëpërmjet rrjeteve kompjuterike.

- Rrjeti mëi rëndësishëm i komunikimit ndërbankar është:

Shoqëria e telekomunikimit financiar ndërbankar mbarëbotërorë (SWIFT)

- Filloi operimin në Evropë me 1973
- Pronë e përbashkët e më shumë se 2000 bankave anëtare
- Lidhë më shumë se 9000 institucione financiare në 200 vende
- Në vitin 2010 SWIFT përpunoi afër 4 trilion urdhëresa

SISTEMET E KOMUNIKIMIT

Pasi marëv jetë eshja verbale të konfirmuar në mënyrë elektronike, nëpërmjet SWIFT, mrëveshja gjithashtu duhet të rregullohet. *Citibank* do të transferojë dollarë tek *BNP Paribas* në SHBA, dhe *Citibank* do të marrë euro nga *BNP Paribas* në Evropë. Transferimi i dollarëve do të bëhet përmes:

Sistemit të pagesave ndërbankare të shtëpisë kliring (CHIPS)
dhe transferimi i eurove do të bëhet përmes

Transferts ekspres të automatizuar transevropiane në kohë reale të shlyerjes bruto (TARGET)

SISTEMET E KOMUNIKIMIT

CHIPS – është sistem i sektorit privat, posedohet dhe operohet nga Kompania e pagesave ndërbankare të shtëpisë kliring (CHIPS Co. Shpk.)

- Anëtarësia e saj përbëhet nga shumica e bankave tregtare më të mëdha në botë
- Është sistem elektronik pagese që transferon fonde dhe rregullon transaksione në dollarë amerikan.
- Në N.York rreth 1,5 trilion \$ të pagesave afariste kalojnë përmes kompjuterëve të CHIPS.
- Pjesmarrësit e CHIPS në tv njëjtën ditë, rregullojnë transferimet e fondeve përmes një llogarie FEDWIRE të veçantë në Bankën e Rezervave Federale në Nju-Jork.

SISTEMET E KOMUNIKIMIT

- FEDWIRE** – është sistem i shlyerjes bruto në kohë reale (RTGS) i drejtuar nga Sistemi i Rezervave Federale të SHBA.
- lidhkompjuterët e mbi 7,000 institucioneve financiare amerikane që kanë depozita në Sistemin e Rezervave Federale
 - Transaksionet në Fedwire menjëherë lëvizin shumat e dollarëve ndërmjet institucioneve financiare.
 - Një transferim kryhet kur zyra e origjinës i transmeton mesazh Bankës së Rezervave Federale, duke treguar se cila është banka paguese dhe pranuese.
 - BRF debiton llogarinë e bankës paguese dhe krediton llogarinë e bankës pranuese

SISTEMET E KOMUNIKIMIT

- ***Kohë reale*** – do të thotë se transaksionet rregullohen porsa të përpunohen;
- **Shlyerje bruto** – do të thotë se transaksionet janë shlyer në bazë një-me-një pa mbledhje ose mbetje me transaksione tjera.

Skema 1.9